
**Documents from the post-byzantine era in the Central State Archive.
The Codex of Korça and Selasfor – a case in point.**

Abstract: *The paper reports on some conclusions of a study on the Codex of the Metropolis of Korça and Selasfor (AQSh, F 488 D 99). The acts recorded date as early as 1676 and end at the beginning of the 20th century. The codex is made of paper. Its approximate size is 260 x 440 mm. The paper is thick and without lines. Containing 190 folios, the codex is bound with a cardboard cover that has been endued with a sheet of leather without decorations. The first written folio (f 5^r) contains a note saying that the codex is property of the Metropolis of Korça and Selasfor, and that it was offered as a gift to this Metropolis in 1676 by Parthenios, Archbishop of Ohrid.*

Written in Greek, the codex gives precious information on the Christian communities during the Ottoman era, namely, on the administration and the judicial, the economical and social realities, the concept of “legal” inside the community and the political reality of the Christian Orthodox communities.

The acts of this codex contain important data about the anarchic situation in Albania during the 17th century. Amongst them, it is worth mentioning the letter that the Christian community of Korça sent to Ali Pasha of Ioannina in the year 1818, or the decisions taken in 1728 in Boboshtica opposing the arbitrary actions of merchants and landowners, when the Ottoman Empire was declining.

The codex also gives plenty of information about the organizational and functional methods of the Elders Committee, elected on January 4th, 1866 “after discussing and reaching an agreement”, as well as information about the different social classes.

Thanks to collective contribution – the documents from this codex read – the streets of the city were cobblestoned (end of the 18th century); the aqueduct was built (1869); a new cemetery was built (end of the 18th century); the clock tower was built (1784), etc. The codex also treasures data concerning the visual arts, e.g. about the brothers Constantine and Athanasios Zografos, who painted not only the churches in Korça, but also those in the surrounding towns.

Gjatë Perandorisë Osmane komunitetet vendore të krishtera të hapësirës shqiptare, dhe jo vetëm ato, u detyruan të organizohen, për të përballuar detyrimet taksore¹, për të zgjidhur problemet lokale dhe për të realizuar veprat e nevojshme fetare dhe veprat me karakter social².

Mekanizmi i mëparshëm kishtar, edhe pse nuk u njoh juridikisht nga shteti osman, u integrua në institucionet e tij, duke fituar, kështu, kompetenca të reja të rëndësishme (administrative, legjislative dhe gjyqësore). Funksionimi i komuniteteve të krishtera rregullohet tashmë nga roli i përtërirë i Kishës³ dhe përfaqësuesit laikë të komuniteteve administrojnë çështjet e brendshme bashkë me klerin⁴. Falë këtij organizimi, komunitetet fituan me kohë një jetë të brendshme politike pak a shumë të ndërlikuar, me zgjedhje të parësisë vendore dhe krijimin e grupeve të tyre të interesit, të cilat, në disa raste, evoluonin në forma politike vendore të mirëkonsoliduara ose jo. Nga zonat rurale, me komunitete më të vogla dhe me forma të thjeshta organizimi, deri tek qytetet, me numër të madh banorësh, mozaik fetar, me specialitete dhe larushi profesionale, me funksionim të esnafëve dhe të sistemeve tregtare, është e qartë se roli i faktorit dhe udhëheqjes kishtarë është mjaft i fortë si në formësimin e mëpasshëm, ashtu edhe në administrimin e komuniteteve të krishtera brenda Perandorisë Osmane⁵.

- 1 Për praktikat fiskale të Kishës Ortodokse shih J. KABRDA, *Le système fiscal de l'Eglise Orthodoxe dans l'Empire Ottoman*: (d'après les documents turcs), Brno: Universita J. E. Purkyne, 1969.
- 2 Mbi funksionet sociale të shih S. PETMEZAS, *Recherches sur les structures économiques et sociales de Pélion (1700-1830)*, thèse de doctorat, E.H.E.S.S., Paris 1989, pjesa 3. G. B. DERTILIS, «Réseaux de crédit et stratégies du capital», në G. DERTILIS (ed.), *Banquiers, Usuriers et Paysans. Réseaux de crédit et stratégies du capital en Grèce (1780-1930)*, Paris 1988, fq. 33-80; K. ΚΩΣΤΗΣ, «Κοινότητες, Εκκλησία και Μιλλέτ στις «Ελληνικές» περιοχές της Οθωμανικής Αυτοκρατορίας κατά την Περίοδο των Μεταρρυθμίσεων», *Μνήμων* 13 (1991), fq. 57-76. Për kundërvëniet ndërmjet elementëve laikë dhe kishtarë shih N. PANTAZOPOULOS, *Church and law in the Balkan Peninsula during the Ottoman Rule*, Thesaloniki 1967, fq. 107-112.
- 3 H. INALCIK, "The Status of the Greek Orthodox Patriarch Under the Ottomans", *Turcica* 21-23 (1991), fq. 4409-435.
- 4 K. PARASKEVAS, *Ottoman Considerations on the Ecumenical Patriarchate, 17th – Beginning of the 20th centuries*, (in Greek) Athens: Alexandria 1998, 295-299.
- 5 Për sistemin komunitar dhe institucionet islame që përcaktonin jetën e të krishterëve gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, shih C. AMANTOS, "La reconnaissance par les Mahométans des droits politiques et religieux des Chrétiens et le décret de Sinan pacha" (in Greek), *Chroniques Épirotes* 5 (1930), fq. 197-210. C. AMANTOS, "The charters of Islam in favor of the Christians", *Hellenica* 9 (1936), fq. 156-157. Ιω. Γ. ΓΙΑΝΝΟΠΟΥΛΟΥ, "Κοινότητες", *Ιστορία του Ελληνικού Έθνους*, vëll. XII, bot. Αθηνών, 1975, fq. 134-143. C. PAPASTATHIS, "Terms of Submission – The "Privileges", *Epirus. 4000 Years of Greek History and Civilization*, Athens: Ekdotike Athenon 1997, fq. 242-244. C. PAPASTATHIS, "Community Life – Justice and Customary Law", *Epirus. 4000 Years of Greek History and Civilization*, Athens: Ekdotike Athenon 1997, fq. 252-257. S. SKENDI, "The Millet System and its Contribution to the Blurring of Orthodox National Identity in Albania", në:

Jeta sociale, ekonomike, kulturore dhe shpirtërore e komuniteteve ortodoks të vendit manifestohej në institucionet e krishtera, domethënë kishat, manastiret dhe shkollat. Objektet e kultit të krishterë gjatë periudhës së pushtimit osman nuk përbënin vetëm vatrën e shprehjes fetare, por edhe qendrën e jetës komunitare, si vend mbledhjeje për bashkësinë, gjithashtu ishin vend i manifestimeve artistike të kohës. Kësisoj, jeta e bashkësive të krishtera gjendet e dëshmuar, kryesisht nga dokumentet kishtarë të ruajtura deri sot e të regjistruara në kodikët kishtarë të kohës.

Koleksioni i kodikëve të dorëshkruar pasbizantine të AQSh-së

Pas çlirimit të vendit nga pushtimi (1944), Shqipëria u vendos plotësisht nën regjimin komunist, gjatë të cilit filloi një përndjekje graduale por e vendosur kundër besimeve fetare, që do të kulmonte me shpalljen zyrtare të Shqipërisë shtet ateist më 1967 dhe me ndalimin e çdo lloj shprehjeje të besimit fetar⁶. Paralelisht me shkatërrimin e qindra kishave dhe manastireve ose shndërrimin e tyre në punishte, depo, deri dhe stalla, shkatërrimin e ikonave, enëve kishtarë e relikuiarëve, u shkatërrua një numër i rëndësishëm librash fetarë ose jo, ndërsa të tjerë kaluan kufijtë e vendit. Në këtë periudhë – sipas dëshmive të laikëve apo klerikëve që i jetuan këto ngjarje nga afër – pas sistematizimit të përndjekjes dhe përmes kërcënimit me internim apo burgim të priftërinjve dhe të laikëve, një pjesë e dorëshkrimeve mbërriti në AQSh, proces ky që vazhdoi deri në fund të viteve '80⁷. Nga kërkimet tona mbi këtë çështje nuk arritëm të gjejmë shumë

Christians and Jews in the Ottoman Empire. The Functioning of a Plural Society, ed. B. BRAUDE – B. LEWIS, vol. 1, London-New York 1982, fq. 243-257. Në lidhje me kanonizmat administrative të komuniteteve të krishtera shih C. PAPASTATHIS, *Οι κανονισμοί των Ὁρθόδοξων ἐλληνικῶν κοινοτήτων τοῦ Ὀθωμανικοῦ κράτους καὶ τῆς διασποράς*, vëll. I, bot. "Ἀδελφῶν Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη 1984. Për organizimin e komunitetit të krishterë të qytetit të Korçës shih A. REMBECI, *The Codex of the Holy Metropolis of Korça and Selasphorus: Edition and Historical Documentation (17th – 19th centuries)* (in Greek), Ionian University 2009, fq. 97-113.

6 Mbi këtë çështje shih A. HOXHA *Marrëdhëniet midis Regjimit Komunist dhe Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë në vitet 1945–1967*, Tiranë: Universiteti i Tiranës, 2014 (25 nëntor 2017), në <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/2014/09/doktoratura-artan-hoxha-fakulteti-i-histori-filologjise-departamenti-i-historise/>, ku gjendet edhe bibliografia respektive.

7 S. ÇUNGA, A. RËMBECI, E. NURJA, "The Central State Archive of Albania. A short history and it's collection of ecclesiastical documents", në: G. ZITO (ed.), *Seconda conferenza di archivisti ecclesiastici europei* (Roma-Sassone, 29-30 prill-1 maj 2013 realizuar me bashkëpunimin e Pontificio Consiglio per la Cultura). Seria: Associazione Archivistica Ecclesiastica – Quaderni di Archiva Ecclesiae 12, Città del Vaticano: Associazione Archivistica Ecclesiastica (Catania : Litografia La Provvidenza), 2014, fq. 35-41. A. RËMBECI, S. ÇUNGA, "The Byzantine and Post Byzantine collection of manuscripts at the Central State Archive of Tirana and a concordance between the Kodder-Trap Catalogue of Tirana Manuscripts and their actual shelf-number" në: *Proceedings of the 22nd Internation-*

elementë lidhur me kohën dhe mënyrën e sjelljes së këtyre dorëshkrimeve në AQSh. Informacionet e sakta janë të pakta dhe u referohen disa nismave të ndërmarra nga AQSh-ja në vitin 1967, për shpëtimin e pasurisë arkivore e librore të komuniteteve fetare në vend⁸. Po ashtu, ekzistojnë edhe të dhëna mbi shitjen e disa dorëshkrimeve tek autoritetet shtetërore nga persona privatë, të cilët kishin shpëtuar pak prej këtyre dorëshkrimeve nga furtuna e shkatërrimit dhe, më vonë, ia shitën AQSh-së⁹. Në këtë mënyrë mbërriti në AQSh, bashkë me dorëshkrime të tjera, edhe kodiku i Korçës nr. 99. Çfarëdo ishte mbledhur në AQSh deri në atë datë u shpëtua nga çmenduria e “Revolucionit për krijimin e njeriut të ri” dhe është ruajtur ende në ditët e sotme. Gjithashtu, të gjitha dokumentet kishtare që arrinin të hynin njëherë në AQSh nuk u konsideruan kurrë në rrezik nga sistemi komunist, por u ruajtën në mënyrë strikte¹⁰.

Fondi 488 me emërtimin “Kodikët e Shqipërisë” në Arkivin Qendror Shtetëror (AQSh)¹¹ mori formën e sotshme në fund të viteve '70, kohë kur u sistemua fondi në fjalë. Përmban të gjitha dorëshkrimet bizantine dhe pasbizantine që u sollën nga raftet e bibliotekave të manastireve, mitropolive apo atyre personale në AQSh. Sot Fondi 488 numëron 119 njësi dokumentash,¹² të cilat kronologjikisht datojnë nga shek. VI - XIX. Sigurisht, dorëshkrimet që u kopjuan apo që ndodheshin në territorin e Shqipërisë së sotshme gjatë periudhës bizantine apo të mëvonshme ishin padyshim shumë më tepër në numër nga sa ruhen sot¹³. Gjallëria dhe lulëzimi kulturor

al Congress of Byzantine Studies, Sofia, 22-27 August 2011, (Sofje: 2011), vol. III, 357.

- 8 Sipas tre raporteve të AQSh-së, me nr. prot. 6/12 i dt. 2 gusht 1967, nr. prot. 6/14 i dt. 8 shtator 1967 dhe një i tretë po i vitit 1967, drejtuar KQ së PSHSH, në vitin 1967 AQSh-ja ndërmori ekspedita për grumbullimin dhe inventarizimin e materialeve arkivore dhe librore që gjendeshin në institucionet fetare të Kishës Ortodokse dhe Romanokato- like në zonën e Shkodrës, Tiranës, Krujës, Durrësit, Beratit, Gjirokastrës. Shih Sh. SINA- NI, *Kodikët kronografikë të Shqipërisë. Shkrime dhe dorëshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare*, Tiranë: Naimi, 36-39, ku gjendet edhe referenca arkivore.
- 9 Dorëshkrime të sjella në AQSh nga persona privatë janë kodiku i Korçës nr. 72, 92 dhe 93, kodiku i Manastirit të Shën Kozmait nr. 100 dhe 12 dorëshkrime/regjistra të tjerë. Për këto të fundit kemi pak informacione, pa arritur t'i identifikojmë. Për dorëshkrimet e tjera nuk gjetëm ndonjë dokument që të saktësojë kohën e sjelljes në AQSh. Shih A. REMBECI, S. ÇUNGA (authors), A. TSELIKAS (scientific supervision), I. VITALIOTIS (con- tributor), *The Illuminated Gospel of Korça. Korça Codex 93 (10th century)*, Facsimile edi- tion, three volumes, Athens: Milotos Edition 2012, fq. 21-28.
- 10 S. ÇUNGA, A. RËMBECI, E. NURJA, *The Central State Archive of Albania*, fq. 35-41.
- 11 Fondi *Kodikët e Shqipërisë 488*, Arkivi Qendror Shtetëror. Emërtimi zyrtar i fondit “Ko- dikët e Shqipërisë” përdoret bashkë me numrin e fondit 488.
- 12 Sipas metodologjisë së punës në arkiv, çdo dokument apo grup dokumentesh konsid- erohet “njësi” dhe mban numër të veçantë brenda fondit. Në rastin tonë jo gjithmonë nënkupton vetëm një dorëshkrim.
- 13 Për dorëshkrime që në të shkuarën kanë qenë pjesë e bibliotekave të qendrave kishtare

i bashkësive ortodokse gjatë shekujve të mëparshëm dëshmohej në mënyrë të pakundërshtueshme nga monumentet e ndryshëm të periudhës paleokristiane, bizantine dhe pasbizantine – monumente arkitekturore të dekoruara me afreske mjeshtërore, si dhe kryevepra të punuara në metal, mikroskulptura, qëndistari, gdhendje druri dhe kodikë të dorëshkruar – që ruhen ende sot në Shqipëri. Këto qendra të rëndësishme shpirtërore dhe kulturore, me rol të rëndësishëm edhe në kohën e sotshme, si Berati, Durrësi, Vlora, Korça, Gjirokastra etj., kishin mbledhur një koleksion të konsiderueshëm kodikësh të dorëshkruar¹⁴.

Përveç Fondit 488 të “Kodikëve të Shqipërisë”, ku ruhen përgjithësisht kodikët e dorëshkruar filologjikë, regjistrat kishtarë janë përfshirë sot edhe në fondeve të tjera arkivore¹⁵:

Dokumentet e Kishës Ortodokse në Arkivin Qendror Shtetëror

Nr. fondit	Emërtimi i fondit	Nr. i dosjeve	Shtrirja kohore
135	Mitropolia e Beratit	49	1781 – 1942
136	Zëvendësia Mitropolitane e Durrësit	743	1862 – 1967
137	Komuniteti Ortodoks i Elbasanit	7	1681 – 1935
138	Manastiri i Shën Joan Vladimirit	20	1863 – 1936
139	Mitropolia e Drinopojës dhe e Gjirokastrës	51	1755 – 1966
140	Manastiri i Kamenës	18	1940 – 1871
141	Mitropolia e Korçës	1379	1710 – 1967
142	Komuniteti Ortodoks i Shkodrës	386	1865 – 1951
488	Kodikët e Shqipërisë (Dorëshkrime bizantine dhe pasbizantine)	119	Shek. VI-XX
536	Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë	1524	1889 - 1967

në hapësirën shqiptare, shih, ndër të tjera, edhe ΑΛΕΞΟΥΣΗΣ Ά., «Κατάλογος τῶν ἐν ταῖς ἱεραῖς ἐκκλησίαις τῆς συνοικίας Κάστρου, πόλεως Βερατίου τῆς Μητροπόλεως Βελεγράδων εὕρισκομένων ἀρχαίων χειρογράφων», *Δελτίον τῆς Ἱστορικῆς καὶ Ἐθνολογικῆς Εἰταιρίας τῆς Ἑλλάδος*, τ. 5, 1900, f. 352-369; BATIFFOL P., « Les manuscrits grecs de Bérat d’Albanie et le Codex Purpureus Φ », *Archives des missions scientifiques et littéraires*, 3e série, Paris, 13 (1887), appendix 2, f. 437-556; ΒΕΗΣ Ν., «Κατάλογος τῶν χειρογράφων κωδίκων τῆς ἀγιωτάτης Μητροπόλεως Ἀργυροκάστρου», *Ἐπετηρίς τοῦ Μεσαιωνικοῦ Ἀρχείου* 4 (1951), f. 129-209. A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 159.

14 Shih: *Répertoire des bibliothèques et des catalogues de manuscrits grecs de Marcel Richard*, Troisième édition entièrement refondue par Jean-Marie OLIVIER, Brepols – Turnhout 1995.

15 S. ÇUNGA, A. RËMBECI, E. NURJA, *The Central State Archive of Albania*, fq. 35-41.

Nga kërkimet e kryera në fondet e sipërpërmendura arkivore të AQSh, Maria Bidika, në disertacionin e saj për mbrojtjen e titullit Master pranë Departamentit të Historisë të Universitetit të Tiranës, ka nxjerrë të dhëna të rëndësishme lidhur me shtrirjen kohore dhe gjeografike të dorëshkrimeve kishtarë pasbizantine të AQSh-së. Sipas këtyre të dhënave rezulton se dorëshkrimet më të hershme administrative kishtarë i përkasin gjysmën e dytë të shek. XVII dhe mbërrijnë deri në fund të shek. XX. Nga kodikët kishtarë të periudhës midis shek. XVII – fillimit të shek. XVIII rezulton të kenë shpëtuar vetëm tetë. Pjesa dërrmuese e kodikëve administrativë kishtarë që ruhen deri sot i përkasin gjysmës së parë të shek. XX dhe ndodhen në fondin 141 të Mitropolisë së Korçës. Kurse gjatë gjysmës së dytë të shek. XX shumicën e kodikëve administrativë kishtarë i kemi në fondin 536 të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Për sa i takon shpërndarjes gjeografike, të dhënat e autores Maria Bidika tregojnë për një përhapje të madhe të kodikëve administrativë kishtarë kryesisht në zonat urbane dhe qendrat administrative kishtarë. Kështu, numri më i madh i kodikëve, rreth 92, evidentohet në qytetin e Korçës, që ishte dhe qendra administrative Mitropolisë së Korçës. Më pas, renditen qendrat kishtarë të Mitropolisë së Beratit dhe të Mitropolisë së Gjirokastrës me 35 dhe 20 kodikë respektivisht. Në vijim, me një numër relativisht të konsiderueshëm prej 17 kodikësh vjen qyteti i Tiranës, pjesë administrative kishtarë e Mitropolisë së Durrësit¹⁶.

Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit (Kod. Ko. 99) si burim historik

Në kodikët pasbizantinë kishtarë të mitropolive, ashtu si edhe ata të kishave dhe manastireve, ruhen burime të rëndësishme për shumë degë të hulumtimit shkencor. Natyrisht, ato janë pjesë e burimeve më të çmuara për studimin e historisë së popullsisë të krishtera në periudhën e pushtimit osman. Në përmbajtjen e tyre dëshmohet organizimi administrativo-gjyqësor, jeta ekonomiko-sociale, konceptet mbi të drejtën dhe jeta e brendshme politike e komuniteteve të krishterë dhe kjo, sepse, ashtu siç është e njohur, perandoria osmane i kishte lëshuar mjaft privilegje administrative nënshtetasve të saj të krishterë. Një burim i kësaj natyre është edhe *Kodiku i Mitropolisë së Perndishpëtuar dhe fort të shenjtë të Korçës dhe Selasforit*. Ky dorëshkrim zë fill në kohën e kryepeshkopit të Ohrit dhe mitropolitit të Korçës, Parthenit, i cili ia dhuroi më 1676 këtë

16 Të dhënat rreth shtrirjes kronologjike dhe gjeografike të kodikëve administrativë kishtarë të periudhës pasbizantine që ruhen në AQSh, janë mbështetur në punën kërkimore të M. BIDIKËS, *Kodikët administrativë kishtarë në AQSh. Rasti i zonës së Korçës*, diplomë e nivelit Master Profesional nën udhëheqjen e A. RËMBECIT, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, 2017, fq. 13-37.

kodik Mitropolisë së Korçës. Në lidhje me këtë në kodik është ruajtur ky shënim: *“Me ndihmën e të shenjtit Perëndi. Kodik i mitropolisë të Perëndishpëtuar dhe fort të shenjtë të Korçës dhe Selasforit, në kohë kur ishte patrik fort i lumuri dhe fort i dituri kryepeshkopi i Justinianës së Parë të Ahridës, z. Parthen nga Korça. Në vitin 1676 nga lindja e Krishtit dhe prej tij [Parthenit] iu dhurua mitropolisë së shenjtë të Korçës”*¹⁷. Kodiku sot ruhet në Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë dhe është përfshirë në fondin 488 me nr. arkivor 99. Kodiku është prej letre perëndimore dhe fletët e tij janë të përmasave 26 x 44 cm. Letra është e trashë, me *vija ujore* (vergeures) dhe *vijëzime* (pontuseaux). Në fletë të caktuara të tij dallohen *shenjat ujore* (filigranet) që paraqiten në formën e tre gjysmëhënave që zmadhohen njëra pas tjetrës¹⁸. Bazuar në tipin e shenjës ujore dhe në llojin e letrës, jemi të mendimit se kodiku është formuar me shumë gjasë në Venedik, duke pasur si destinacionin prapatokën e Perandorisë Osmane. Po ashtu, në pjesën e jashtme të trupit të fletëve ekzistojnë shënjes alfabetikë, fakt që na bën të besojmë se kodiku, përpara se t’i dhurohej Mitropolisë së Korçës nga kryepeshkop Partheni, ka pasur qëllim të përdorej si regjistër tregtar apo financiar. Kapakët e kodikut janë prej kartoni të presuar, të veshur me lëkurë ngjyrë kafe të çelët pa elementë dekorativë. Përmban 190 fletë, të cilat mbajnë 4 numërtime të ndryshme. I fundit është kryer nga AQSh-ja dhe duket më i sakti në krahasim me tre të tjerët.

Kodiku është i shkruar në greqisht, d.m.th. në gjuhën zyrtare të Kishës Ortodokse gjatë periudhës osmane. Një pjesë e dokumentave paraqiten me saktësi drejtshkrimore dhe përdorim të mirë të gjuhës greke, ndërsa pjesa tjetër është krejtësisht me pasaktësi ortografike dhe e përzier edhe me elementë të gjuhës lokale shqipe, gjë që shumë herë vështirëson kuptim e përmbajtjes së teksteve. Në disa shkresa të kodikut ndeshim edhe nënshkrimin karakteristik me ngjyrë jeshile të Kryepeshkopëve të Ohrit¹⁹.

Kodiku është përdorur pjesërisht si burim nga hulumtues të ndryshëm të huaj dhe vendas të fundit të shek. XIX dhe shek. XX²⁰. Por këto përpjekje

17 “Σὺν Θεῷ ἀγίῳ ἰ² Κώδιξ τῆς θεοσώστου καὶ ἀγίω(τά)της ἰ³ μ(η)τροπόλ(εω)ς Κοριτζᾶς καὶ Σελασφόρου ἰ⁴ ἑξαρχοῦντος καὶ π(α)τριαρχεύοντος ἰ⁵ τοῦ μακαριωτάτου καὶ λογιω(τά)του ἀρχ(ιε)πισκόπου ἰ⁶ τ(ῆς) πρώτης Ἰουστιανῆς Ἀχρειδῶν κ(υρίο)ν κ(υρίο)ν ἰ⁷ κύρ Παρθενίου τοῦ ἐκ Κοριτζᾶς. Ἀπὸ Χ(ριστο)ῦ [ἐν] ἔτ<ει> ἰ⁸ ,αχοστ^ω καὶ παρ’ αὐτοῦ ἀφιερῶθη τι ἀγία μ(η)τροπόλει”. A. RĚMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 1, fq. 203.

18 Shenja ujore ndeshim në fletët 35, 73, 75-76, 79-80. A. RĚMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, fq. 173.

19 A. RĚMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 58 (36r), 59 (36v), fq. 253-255.

20 Në pamundësi për të paraqitur bibliografinë shteruese mbi kodikun e Korçës nr. 99, për shkak të hapësirës së kufizuar dhe të karakterit të këtij artikulli, po përmendim vetëm emrat e studiuesve kryesorë: Thimi Mitko, Nuçi Naçi, Joakim Martinianos-i mitropolit i Ksanthit, Anthim Aleksudhi mitropolit i Beratit, Harallamb Karmici, Heinrich

nuk ofrojnë një pamje të plotë të përmbajtjes së kodikut dhe as janë të mjaftueshme për nxjerrjen e përfundimeve të sigurta mbi rrethanat që ekzistonin në kohën e shkrimit të dorëshkrimit.²¹

Përsa i përket përmbajtjes së kodikut, vërehet se, ashtu si edhe tek kodikët e tjerë kishtarë, edhe këtu janë regjistruar leje martesash apo divorcesh, marrëveshje prikash, testamente, vendime mbi mosmarrëveshje trashëgimore, vendime gjyqësore, akte likuidimesh, marrëveshje të esnafëve dhe kopje të letrave patriarkale lidhur me çështje të ndryshme administrative të peshkopatave lokale.

Në vijim, do të përqendrohemi në paraqitjen e aspektit historik, shoqëror, ekonomik dhe kulturor, mbi të cilat hedh dritë me të dhënat e tij kodiku në fjalë

Të dhëna të kodikut që lidhem me jetën historike të zonës

Venitja e Perandorisë Osmane, që filloi që nga mesi i shek. XVII, çoi në dobësimin e pushtetit qendror dhe zhvillimin e pushteteve lokale periferike. Kjo situatë i detyroi bejlerët Shqiptarë që të mbështeteshin më tepër në forcën paraushtarake vendore, sesa në administratën qendrore osmane. Bejlerët i shtrinin vazhdimisht kufijtë e pashallëqeve të tyre, duke fituar në këtë mënyrë të ardhura dhe pushtet. Por kjo situatë e krijuar çoi në konkurrencë mes bejlerëve më të fuqishëm dhe atyre më pak të fuqishëm, gjë që i çoi zonat e gjera të Shqipërisë në anarki²².

Gelzer, Ilo Mitko Qafëzezi, Petraq Pepo, Pirro Thomo, Kosta Naçi, Shaban Sinani, Andi Rembeci, S. Çunga etj. Për referenca të plota bibliografike deri më 2009, shih A. RËMBECI, *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*: bibliografi. Për studime të kryera pas vitit 2009, shih paraqitjen bibliografike të Sh. SINANI, "Një nga kodikët e Korçës", në *Kodikët kronografikë të Shqipërisë*, bot. Naimi, Tiranë 2014, f. 383-410

21 Edhe pse njoftimi për ekzistencën e kodikut të Korçës nr. 99 dhe realizimi i studimeve të mbështetura në regjistrimet e tij nisën që në shek. XIX, i pari që ndërmori botimin në shqip të regjistrimeve të tij në formë shaptilografike, për nevoja të brendshme burimologjike të Institutit të Historisë, është Petraq Pepo (*Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shekullit XVIII-fillimi i shekullit XX (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit)*, vëll. I-II, bot. Akademia e Shkencave – Instituti i Historisë, Tiranë 1981). Për shkak se në botimin shqip të regjistrimeve të kodikut u konstatuan probleme, sikundër edhe vetë autori përmend "*Në përkthime tekstesh të këtij lloji, të metat nuk janë të rralla, por lexuesi ka mundësi t'i kontrollojë, pasi ne kemi dhënë dhe materialet origjinale të kodikut*" dhe, duke qenë se materialet në origjinal të kodikut nuk janë dhënë, sikundër deklarohet prej autorit, për shmangien e gabimeve të mundshme, në vitin 2009 autori i këtij studimi përgatiti botimin e plotë të kodikut, shoqëruar me transkriptimin dhe studimin përkatës: A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus: Edition and Historical Documentation (17th – 19th centuries)* (in Greek), Kerkyra: Ionian University 2009.

22 D. QUATAERT, *The Ottoman Empire 1700-1922*, New York, Cambridge University Press, 2005, (in Greek), Athens 2006, fq. 180-181. Shih, po ashtu, Γκ. ΑΡΣ, *Η Αλβανία και η Ήπειρος στα τέλη του ΙΗ και στις αρχές του ΙΘ αιώνα*, Αv. ΔΕΛΛΑ (trans.), bot. Γκού-τεμπεργκ, Αθήνα 1994, fq. 62-64. M. VICKERS, *The Albanians: A Modern History*, (in

Në kodikun e Korçës rezultojnë të dhëna të rëndësishme historike lidhur me atë gjendje tragjike që sundonte kryesisht në hapësirën juridiksionit kishtar të Mitropolisë së Korçës. Vërejmë kështu se feudalët e zonës së Korçës, akoma edhe gjatë sundimit të Ali pashë Tepelenës, vazhdonin që të ushtronin abuzimet me vjeljen e taksave. Karakteristik është rasti i letrës që përfaqësues të komunitetit të krishterë të Korçës i dërgojnë më 1818 Ali pashës, ku përmenden ankesat e komunitetit për haraçet dhe angaritë që i detyronin të bënë Ali beu dhe Ismail beu, feudalë të fuqishëm të Plasës. Komuniteti edhe pse u kishte dhënë këtyre feudalëve, sipas porosisë së Ali pashës, një shumë të caktuar të hollash dhe lënde duri, detyrohej që të paguante akoma më tepër haraçe dhe sasi më të mëdha lënde druri. Duke qenë se komuniteti nuk kishte mundësi të paguante çka u kërkonin më tepër feudalët, atëherë këta të fundit kishin burgosur një pjesë të banorëve²³.

Të një rëndësie të veçantë për historinë e Shqipërisë janë edhe dokumentet që hedhin dritë mbi marrëdhëniet mes banorëve të fshatrave të Iljaz beut, të mytevelive të vakëfeve respektive dhe të feudalëve apo agave që shtreshin si mbrojtës të vendit. Janë të admirueshme përpjekjet organizative dhe unifikuese të banorëve të fshatrave për t'u përballur me shpërdorimet dhe abuzimet, që sa vinin e shtoheshin dhe rëndonin kushtet e jetesës së tyre. Këto abuzime shkaktuan reagimin e banorëve të fshatrave, të cilët, më 1728 në manastirin e Shën Nikollës në Boboshticë, në praninë e të gjithë fshatrave vakëfe, të klerikëve dhe laikëve, të ndërmjetësve dhe esnafeve vendosën: së pari, të ndaheshin fshatrat vakëfe nga vilajeti i Voskopojës, së dyti, këto fshatra të organizoheshin sipas traditës së tyre dhe, së treti, do të njëjhej vetëm i dërguari i qeverisë osmane edhe pse ky nuk kishte të drejtë të ndërhynte në punët e brendshme të fshatrave²⁴.

Këto vendime të mbledhjes në Boboshticë tregojnë nga njëra anë orvatjet për të ndërmarrë iniciativa ndaj arbitrarizmave gjithnjë e në rritje të tregtarëve dhe feudalëve dhe, nga ana tjetër, organizimin – në nivel administrativ dhe ekonomik – të banorëve të fshatrave sipas zakoneve dhe traditës së tyre, në një kohë kur perandoria osmane kishte filluar të dobësohej.

Greek), bot. Οδυσσεύς, Athens 1997, fq. 42. Γκ. Αρς, *Η Αλβανία και η Ήπειρος*, fq. 63-66. Κ. ΒΑΚΑΛΟΠΟΥΛΟΣ, *Ιστορία του Βόρειου Ελληνισμού, Ήπειρος*, εκδ. Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη 1992, fq. 170-171.

23 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, fl. 105.

24 *Ibid.*, dok. 85, 274-276.




FIGURA 2

Vendimet e mbledhjes së të krishterëve në kishën e Shën Nikollës
në Boboshticë më 1728 (f. 48r)



FIGURA 4

Nxënës të shkollës publike të Korçës.

Të dhëna të kodikut që lidhem me organizimin e komunitetit të krishterë të Korçës

Komuniteti ortodoks i Korçës, ashtu si edhe çdo komunitet tjetër fetar apo kombëtar brenda territorit të Perandorisë Osmane, pas nxjerrjes së Hatt-i Humayun më 1856 dhe duke pasur si kryetar politik dhe shpirtëror Patriarkun Ekumenik, iu dha e drejta për të formuar një këshill dhe të rregullonte çështjet fetare dhe civile sipas zakoneve vendore dhe nevojeve²⁵. Me liritë fetare që u dekretuan me Reformat e Tanzimatit²⁶

25 A. BON, *State and Economic in Middle East*, (London, 1955), fq. 13. S. N. FISHER, *The Middle East: A History*, (London, 1971), fq. 319. Π. ΚΟΝΟΡΤΑ, «Η οθωμανική κρίση του τέλους του ΙΣΤ' αιώνα και το Οικουμενικό Πατριαρχείο», *Τα Ιστορικά*, vëll. 2, fash. 3, 1985, fq. 45-76.

26 Mbi reformat e Tanzimatit, shih B. LEWIS, *The Emergence of Modern Turkey*, London:

dhe të rrethanave favorizuese të një zhvillimi gradual ekonomik e social, qytetarët e komunitetit të krishterë të Korçës vendosën më 4 janar 1866 “*duke e pleqëruar dhe rënë në një mendje, të caktojnë kryepreqësinë*”²⁷. Në kodikun e Korçës janë ruajtur të dhëna të pasura lidhur me organizimin dhe funksionimin e kryepreqësisë. Dokumenti i themelimit të kryepreqësisë, që është regjistruar në këtë kodik përmend në mënyrë karakteristike këto: “*caktuam kryepreqësinë që do të përfaqësojë të gjithë qytetin tonë dhe që përbëhet nga këto tetë vetë... të cilët premtuan dhe janë të detyruar të kujdesen me ndërgjegje të pastër dhe me sinqeritet të plotë për ato që lidhen me të mirën dhe interesin e qytetit tonë*”²⁸. Të gjitha rregullat që janë regjistruar të shpërndarë në kodikun e Korçës deri më 1866, nuk kanë formën e një kanonizme. E megjithatë, ato e luanin rolin e kanonizmave, sepse rregullonin marrëdhëniet brenda dhe jashtë komunitetit, si p.sh. kanonet për rregullimin e çështjeve kishtarë²⁹, e çështjeve të brendshme³⁰ dhe të jashtme³¹ të komunitetit, të administrimit të funksioneve të brendshme të esnafëve³² etj.

Mes informacioneve të çmuara të kodikut, ndeshemi me të dhëna që

Oxford University Press, 1961), 73-170, S. J. SHAW – SHAW E. K., *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, vol. 2, Cambridge: Cambridge University Press, 1997, 55-171, N. BERKES, *The Development of Secularism in Turkey*, New York: Routledge, 1998, 137-200. Për rastin e Shqipërisë krhs. Z. SHKODRA, *Shqipëria në kohën e Tanzimatit*, Tiranë: Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, Seksioni për Përhapjen e Njohurive Teknikoshkencore, 1959.

27 «...σκεφθέντες ὡρίμως ... ἅπαντες ἐκ συμφώνου καὶ διορίσαμεν δημογεροντίαν...». A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 122, 309-310.

28 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 122⁴⁻¹⁰, 309-310.

29 *Ibid.*, dok. 98, 286: “*Shkresë për qëndrimin në fuqi të vendimit me dt. 20 tetor 1763 mbi ushtrimin e kryeprihtërisë së Dionisit*”.

30 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 62, fq. 257-258: “*Vendim i varoshllinjve të Korçës për shitjen e arrave, truejve, shtëpive, punishteve, vreshtave, plevicave etj. për shlyerjen e detyrimit të vjetër dhe të taksës vjetore mbretërore*”; dok. 86, fq. 277-278: “*Mbi kanonet për kufizimin e shpenzimeve e fejesave dhe të martesave*”; dok. 90, fq. 279-280: “*Vendimi i varoshllinjve të qytetit të Korçës për shpenzimet e nuses dhe të dhëndrit*”.

Ως ἀνω, φφ. 39^r, 49^v-50^r, 51^r-52^r

31 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 103, fq. 290-291: “*Shkresë për dërgimin e ekzarkëve të Patriarkanës Ekumenike për të shqyrtuar konfliktin mes kryepriiftit dhe komunitetit*”

32 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 18, fq. 229: “*Njoftim i esnafit të Kasapëve për të mos therë mish të dielave, festave despotike dhe hyjlindësore*”; dok. 35, fq. 236: “*Shpresë për shlyerjen e detyrimit që esnafi i Kasapëve kishte ndaj Kishës*”; dok. 66, fq. 260: “*Kushtim i esnafëve të tabakëve, papuxhinjve, terzinjve, qyrkxinjve, çarëkxinjve, kasapëve, samarxinjve të varoshit të Korçës për shkollën e përbashkët, që të mësojnë fëmijët falas*”; dok. 79, fq. 271: “*Vendim i esnafit të bukëpjekësve për përgatitjen e llojeve të bukëve dhe për kriteret e marrjes së çirakëve*”.

lidhen me marrëdhëniet ndërmjet kryepleqësisë dhe Mitropolitit apo taksambledhësve të komunitetit të Korçës, të cilat jo gjithnjë ishin të mira dhe harmonike. Karakteristik është rasti i konfliktit të ashpër mes komunitetit dhe Mitropolitit Neofit të Korçës. Për shqyrtimin dhe zgjidhjen e konfliktit, Patriarku Ekumenik i Konstantinopojës dërgoi më 1862 si ekzarkë peshkopin e Servive dhe Kozanit, z. Eugeni dhe hierodhiakonin e Patriarkanës, z. Gjermano³³.

Së fundmi, përmbajtja e testamenteve³⁴ që ndodhen të shkruar në faqet e kodikut të Korçës dhe Selasforit ndriçon mjaft anë të jetës së banorëve të qytetit dhe nxjerr në pah shtresat e ndryshme shoqërore. Është për t'u theksuar testamenti i arkondit të Korçës, Marko Vasilit, i cili na dëfton ekzistencën e një shtresë së ngritur shoqërore në qytetin e Korçës në fundin e shek. XVIII.

Të dhëna të kodikut që lidhem me jetën ekonomike të komunitetit të krishterë të Korçës.

Që prej shek. XIX në Korçë vërehet një shtrirje gjithnjë e në rritje e marrëdhënieve tregtare dhe esnafore. Për këto, të dhëna shumë të çmuara na kanë lënë udhëtarët e ndryshëm të periudhës. Johan von Hahn në lidhje me fuqizimin e esnafëve dhe zhvillimin e marrëdhënieve tregtare, shkruan: «... zhvillimi i beftë i Korçës u favorizua jo vetëm nga ndërprerja e marrëdhënieve tregtare me Janinë dhe me lidhjen e marrëdhënieve të drejtpërdrejta tregtare me Triesten, por edhe nga pozicioni strategjik që zotëron qyteti në kryqëzimin e rrjeteve të rëndësishme rrugore ...»³⁵. Krah tyre një ndihmë të vyer sjell edhe kodiku i Korçës, i cili na ofron të dhëna të tjera respektive mjaft të rëndësishme.

Prona dhe pasuria e komunitetit të krishterë të Korçës vinte nga burime të ndryshme, sikundër dëshmohet edhe në fletët e kodikut të Korçës. Fletë të tëra janë të mbushura me katalogë dhuratash që bënin qytetarët dhe të mërguarit korçarë, kryesisht të Rumanisë dhe të Egjiptit. Ndërmjet dhuratave mund të dallohen arra, vreshta, shtëpi, dyqane, shuma monetare etj. Dhuruesit më së shumti i përkasin shtresës së mjeshtëurve dhe teknikëve. Këto të dhëna dëshmojnë, për më tepër, se Korça, si edhe qytete të tjera të Perandorisë Osmane, e kishte mbështetur ekonominë e saj me funksionimin e shoqatave me karakter tregtar, të njohura me emrin

33 Shih, më sipër, referencën 32.

34 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 39, fq. 237: "Testamenti i arkondit të Korçës, Marko Vasili, i cili ua ndan pasurinë e tij anëtarëve të familjes"; dok.42, fq. 238-240: "Teksti origjinal i testamentit të saqellar atë Manushi, i cili e ndan pasurinë e tij tek anëtarët e familjes". Shih, po ashtu, dok. 102, fq. 289-290 (59v), 149, fq. 327-330 (77v-79r).

35 J. G. VON HAHN, *Studime Shqiptare*, Tiranë: IDK, fq. 82.

zejtari ose siç quhen ndryshe në Kodikun e Korçës³⁶, rufete³⁷, esnape apo sinape³⁸. Esnafet kishin si qëllim mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, prodhimin dhe tregtimin e produkteve, përparimin ekonomik, por edhe zhvillimin e frymës së solidaritetit³⁹.

Sipas të dhënave të kodikut, në Korçë ushtronin veprimtarinë e tyre esnafet e rrobaqepësve, e bakejve, e lëkurëregjësve (tabakëve), e gëzofpunuesve, e këpucëbërësve, e shalëbërësve, e arpunuesve, e opingarëve, e kasapëve, e furrtarëve, e kazanxhinjve (kazanpunuesve), e bakërzhinjve (bakërpunuesve), e armëpunuesve, e Pararendësit të Nderuar (Shën Joan Pagëzorit), e Shën Thanasit, e Shën Konstandinit etj⁴⁰.

Mënyra e funksionimit të esnafeve në Korçë rregullohej, që nga shek. XVI, me hartimin e kanonizmave (rregulloreve) dhe, më vonë, me përpilimin e statuteve në bazë të qëllimeve dhe nevojave të esnafeve. Sigurisht, që rregullat e esnafëve të Korçës, ashtu si edhe në të gjithë shtrirjen osmane, inkadroheshin brenda traditave zakonore apo legjislacionit osman⁴¹. Dekretimi i kanonizmave dhe i statuteve luante një rol të rëndësishëm si në kuadrin organizativ të esnafeve, ashtu edhe në kontrollin e ndryshimeve dhe zhvillimeve graduale profesionale brenda esnafit⁴². Të dhëna të kësaj natyre gjenden të shënuara në Kodikun e Korçës në formën e kanonizmës (rregullores), si p.sh. neni i rregullores së esnafit të furrtarëve, i cili ndalon largimin për çfarëdolloj arsye të çirakut nga esnafi përpara kohës së caktuar dhe, në rast mosbindje, u ndalon të gjithë zejtarëve të tjerë që ta pranojnë

36 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 7, 9, 21, 25, 66, 67, 68, 85, 88, etj.

37 Fjala *rufet* apo *urfet* e ka prejardhjen nga arabishtja dhe do të thotë lidhje, bashkim i njerëzve që ushtrojnë një zanat me qëllime përfituese. Γ. ΠΑΠΑΓΕΩΡΓΙΟΥ, *Οι συντεχνίες στα Γιάννινα κατά τον 19^ο και αρχές του 20^{ου} αιώνα*, Ιωάννινα 1982, fq. 19, shën. 19. A. ΧΑΤΖΗΜΙΧΑΛΗ, «Οι συντεχνίες - τὰ ἰσνάφια», botim në fashikull të veçantë nga *Ἐπετηρίδα τῆς Ἀνώτατης Σχολῆς Βιομηχανικῶν Σπουδῶν*, vëll. 2 (1949-1950), Athinë 1950, fq. 3, shën 2. A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, fq. 106.

38 Fjala *esnaf* është fjalë turke dhe sipas të gjitha gjasave e ka prejardhjen nga fjala arabe *snif* (فانص), në shumës *esnaf* (فانصا), që do të thotë klasë, rend dhe në një kontekst më të gjerë *rendi tregtar, profesional, i zanatçinjve, i zejtarëve* etj., përtej organizimeve më specifike. Për këtë shih N. ΖΙΑΓΚΟΣ, *Τουρκοκρατούμενη Ἑπειρος. Τιμαριωτισμός, αστισμός, νεοελληνική αναγέννηση (1648-1820)*, Ἀθήνα 1994. M. Γ. ΜΟΣΧΟΠΟΥΛΟΣ, në zërin «Ἐσνάφι», *Μ.Ε.Ε.* 11 (1934). Β. ΜΥΣΤΑΚΙΔΗΣ, «Τὰ ἑσνάφια, ἤτοι ρουφέτια τῆς Θεσσαλονίκης», *Ἡμερολόγιον Θεσσαλονίκης*, 1932, fq. 281. Rreth varianteve të kësaj fjale, si *isnaf*, *isnafi*, *sinafi*, *esnafi*, *sinafia* etj., shih ΒΟΥΡΑΤΖΕΛΗΣ - ΜΑΡΙΑΝΑΚΟΣ, *Αἱ ἐν Θράκῃ συντεχνίαι τῶν Ἑλλήνων κατά τὴν Τουρκοκρατίαν*, Θεσσαλονίκη 1950, fq. 79.

39 Γ. ΠΑΠΑΓΕΩΡΓΙΟΥ Γ., *Οι συντεχνίες στα Γιάννινα*, fq. 101.

40 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 3, 7, 9, 21, 25, 66, 67, 68.

41 Z. SHKODRA, *Les corporations albanaises*, fq. 178-179; Shih po ashtu K. ΒΑΚΑΛΟΠΟΥΛΟΣ, *Ἱστορία τοῦ Βόρειου Ἑλληνισμοῦ*, fq. 70-77 dhe Γ. ΠΑΠΑΓΕΩΡΓΙΟΥ, *Οι συντεχνίες στα Γιάννινα*, fq. 21-22.

42 Γ. ΠΑΠΑΓΕΩΡΓΙΟΥ, *Οι συντεχνίες στα Γιάννινα*, fq. 21-22.

atë: «Një bukëpjekës e ka të ndaluar të pranojë çirakun e një bukëpjekësi tjetër përpara se ai të përfundojë kohën e rënë dakord. Nëse ndonjë shërbëtor do të largohet para kohe nga mjeshtri i tij, atëherë ai ka për të mbetur i papunë»⁴³.

Pazari i qytetit dispononte hotele, punishte dhe rreth 800 dyqane. Edhe pse pazari i Korçës ishte më i vogël se ai i Manastirit, shumë mendonin se lëvizja tregtare në Korçë ishte më e madhe dhe kjo sepse qyteti përbënte një depo natyrore për të gjitha produktet esnafore dhe industriale sic përmendet edhe në kodik se "...atë javë shumë nga tregtarët kishin sjellë të gjithë gjënë e tyre nga Trieste dhe Venecia..."⁴⁴. këto produkte prodhoheshin nga punishtet lokale ose vinin nga qendrat perëndimore dhe tregtoheshin në hapësirën shqiptare dhe më tej. Në kodik përmenden, gjithashtu, edhe tre rëniet e zjarrit (1822, 1858 και 1879), të cilat e bënë pazarin e Korçës "shkrumb e hi" dhe i shkaktuan qytetarëve më 1879 dëme shumë të mëdha, sepse "zjarri dogji në gjithë pazarin e Korçës rreth 600 dyqane, të cilat u bënë shkrumb e hi, vetëm në qoshet e pazarit arritën t'u shpëtonin flakëve të zjarrit rreth 100 dyqane. Dëmi i shkaktuar i tejkalonte 20.000 lira".⁴⁵

Kodiku i Korçës përmban të dhëna të vyera edhe për themelimin dhe funksionimin e erkës komunitare, të quajtur "Llaso", e cila u themelua më 1850 nga Mitropoliti i Korçës, Neofiti (1845-1878)⁴⁶. Arsyet që shtynë Neofitin të themelonte arkën e Llasos ishte ruajtja e të gjitha dhuratave të të mërguarve korçarë, siguria e menaxhimit të ndershëm si edhe nxitja e zellit arsimdashës të korçarëve të tjerë. Rreth themelimit të Llasos, lexojmë këto shënime në kodik: "*Gjatë vitit 1850 banorët e Korçës shprehën idenë e mirë të themelimit të një arke të hirshme, të quajtur Llaso në kohën e kryeprihtërisë së Mitropolitit fort të hirshëm, z. Neofiti nga Gjirokastra. Për këtë arsye, iu drejtuan bashkatdhetarëve të tyre të mërguar në Egjipt, të cilët, pasi pranuan kërkesën e tyre dhe mblodhën kontribute rreth 100 lira, numër 100, ia dërguan parisë së Korçës me një letër të veçantë. Ata duke i marrë me mirënjohje këtë shumë në dorëzim dhe si i mblodhën në Mitropoli, i ftuan të gjithë qytetarët dhe me festime panegjirke dhe me emocione në zemër i nxitën që të ndjekin shembullin e bashkatdhetarëve të tyre në Egjipt. Dhe si regjistruan kontributet krijuan menjëherë një kapital prej njëzetë*

43 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 79.

44 «...τὴν αὐτὴν ἐκεῖνην ἐβδομάδα πολλοὶ τῶν ἐμπόρων εἶχον φέρει ὅλας των τὰς πραγματείας ἀπὸ Τριέστιον καὶ Βενετίαν...». A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 36 (26r), fq. 206.

45 «...καθ' ὅλην τὴν ἀγοράν ἀποτέφρωσε περὶ τὰ ἐξακόσια ἐργαστήρια, ἅτινα ἐγένοντο παρανάλωμα τοῦ πυρός, μόνον δέ κατὰ τὰς ἄκρας τῆς ἀγορᾶς διεσώθηκαν ἑως ἑκατὸν ἐργαστήρια, ἡ ζημία ὑπολογίσθη ὑπὲρ τὰς εἴκοσι χιλιάδας λίρας...». A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 162 (88v), 352

46 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 41 (27r), fq. 238.

*mijë groshë, 20.000, të cilat menjëherë i dhanë me kamatë...*⁴⁷. Qëllimi bazik i Llasos ishte çelja dhe mirëmbajtja e shkollave të qytetit. Në arkën komunitare kontribuonin të gjithë qytetarët, por sidomos të mërguarit prej të cilëve vinin edhe kapitalet më të mëdha. Në kodikun e Korçën janë regjistruar, gjithashtu, të dhëna me vlerë mbi ecurinë pasurore të arkës së Llasos, ecuri që është e lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të qytetit⁴⁸.

Është më se i dukshme, pra, roli i rëndësishëm që nisi të luaj në shek. XIX diaspora në jetën ekonomike dhe shoqërore të qytetit të Korçës, të cilët janë pararendësit e vizionit të rilindjes kombëtare të shqiptarëve.

Të dhëna të kodikut që lidhem me zhvillimin e arsimit dhe të veprimtarive kulturore

Deri në shek. XVIII, qeveria osmane nuk ishte kujdesur për krijimin e një sistemi publik arsimor dhe, si edhe në perëndim, arsimi mbetej çështje e krerëve kishtarë⁴⁹. Komuniteti i krishterë i Korçës, si edhe të gjithë të krishterët e Perandorisë Osmane gjendeshin në udhëheqjen fetare, politike dhe kulturore të Patriarkanës Ekumenike dhe, rrjedhimisht, në shprehjet e tyre kulturore dhe në sektorin e arsimit përdornin gjuhën greke⁵⁰. Krijimi i rrjetit arsimor në qytet përbënte ingranazhin kryesor për formimin e një shoqërie përparimtare qytetare.

Shkolla e parë në Korçë, në të cilën mësonin jo vetëm nxënës nga qyteti, por edhe nga fshatrat përfaqë, u çel në vitin 1724⁵¹. Për të fuqizuar veprimtarinë arsimore të shkollës, komuniteti i krishterë i Korçës me mbështetjen e kryepeshkopit të Ahridës, Joasafit, ndërmori një fushatë për grumbullimin e të ardhurave. Ndërmjet dhuruesve, që mbështetën zhvillimin arsimor në Korçë, një vend të veçantë zë princi i Hungrovllahisë, Joan Mavrokordhati, i cili *“... i dhuroi nëpërmjet një hrisobule autentike Mitropolisë fort të shenjtë të Korçës dhe Selasforit 150 groshë në vit për themelimin e shkollës...”*⁵².

47 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 160/6 (85^{r-v}), fq. 343-344.

48 *Ivi*.

49 Θ. ΧΑΡΙΑΔ, Θ., - Α. ΙΣΜΗΝΗ, *L' education elementaire en Angleterre, en France et en Grece pendant le dix - neuvieme sicle (1800 - 1870)*, DOI: 10.12681/eadd/14731, fq. 23.

50 P. ΠΕΡΟ, «Kodikun i madh i Korçës si burim historik - Zhvillimi i arsimit dhe kulturës kishtarë», *Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë 1965, fq. 535-536. Shih, po ashtu, M. ΝΥΣΤΑΖΟΠΟΥΛΟΥ-ΠΕΛΕΚΙΔΟΥ, *Οι βαλκανικοί λαοί*, Θεσσαλονίκη 1991, fq. 83.

51 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 7 (11^r-14^v), fq. 208 dhe dok. 160/5 (84^v-85^r), fq. 341-343. Shih, gjithashtu, I. ΛΑΜΠΡΙΔΗΣ, *Περί των εν Ηπείρω αγαθοεργημάτων*, vëll. 1, Γ. Κιούση (ed.), εν Αθήναις 1880, fq. 157, Φ. ΟΙΚΟΝΟΜΟΥ, *Τα σχολεία της ενιαίας Ηπείρου στους χρόνους της Τουρκοκρατίας (1453-1913)*, Αθήναι 1987, fq. 89.

52 «...ἀφιέρωσε διά χρυσοβούλου Αύθεντικῷ τῇ αὐτῇ ἀγιωτάτῃ μητροπόλει Κορυτζᾶς καὶ Σελασφόρου γρόσια ἑκατόν πεντήκοντα καθ' ἑκάστον ἔτος, εἰς σύστασιν σχολείου...». A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 7 (11^r-14^v), fq. 208 dhe dok.

Mbështetje të rëndësishme financiare për funksionimin e shkollave kanë dhënë edhe esnafet, të cilat mbulonin një pjesë të madhe të shpenzimeve dhe të mërguarit në Egjipt, të cilët fuqizojnë arsimin në qytet duke siguruar mësues të rinj të metodave bashkëkohore.

Gjatë shek. XIX, komuniteti i krishterë i Korçës, qytet kryesisht tregtar, që më 1860 përbënte 2/3 e numrit total prej 15.000 banorësh, duke pasur në duar 800 dyqane dhe me të ardhura nga mërgimtarët që më 1859 kapnin shumën vjetore të 525 lirave, fillon të zhvillohet nga ana ekonomike dhe sociale dhe të organizohet më mirë⁵³.

Nga kodiku rezulton, për shembull, se rreth vitit 1830 në Korçë hapet shkollë me mbështetjen e veçantë të tregtarëve të Egjiptit⁵⁴. Ndërsa në vitin 1856 rindërtohet shkolla e re brenda oborrit të kishës metropolitane⁵⁵. Pas një viti, komuniteti i krishterë i Korçës çel shkollën e vashave (Parthenagogjion), në të cilën studionin rreth 150 vajza⁵⁶. Institucioni më i rëndësishëm arsimor që funksiononte në Korçë ishte shkolla e themeluar me kontributin e Joan Bankës⁵⁷. Ky tregtar nga Korça, pasi kishte krijuar pasuri në Egjipt, u aktivizua pas vitit 1850 bashkë me bashkatdhetarë të tjerë për të fuqizuar arsimin në vendlindjen e tij. Banka fuqizoi arkën komunitare të Llasos, e cila përdorej për qëllime arsimore dhe, që atëkohë, për nder të tij mori emrin “Banka”.

Brenda materialit të shumtë të kodikut zbulohet edhe një tjetër aspekt i jetës në Korçë, ai i veprimtarisë kulturore, që pasqyrohet ndjeshëm edhe në sektorin urbanistik dhe ndërtimor. Karakteristike janë veprimet e vazhdueshme të banorëve të Korçës për përmirësimin e infrastrukturës dhe kryerjen e veprave të së mirës së përbashkët si p.sh. shtrimi me kalldrëm i rrugëve të qytetit (shek. 18)⁵⁸, sjellja e ujit të pijshëm dhe instalimi i çezmave brenda në qytet (1869)⁵⁹, hapja e varrezës së re (fundi

160/5 (84^v-85^r), fq. 341-343,

53 A. ISMIRLIADOU, *Koritsa: Education, Benefactors, Economy, 1850-1908*, Thessaloniki 1997, fq. 63.

54 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 160/5 (84^v-85^r), fq. 341-343. T. EVANGELIDIS, *Η παιδεία επί Τουρκοκρατίας*, vëll. 1, εν Αθήναις 1936, fq. 129-130.

55 Në krahun e djathtë të godinës së shkollës ndodhej ky mbishkrim ktitorik: «Themelohet kjo shkollë publike më 1856, në kohën e kujdestarisë së z. Kristo Godhi dhe Dhimitër Shomo». X. ΚΑΡΜΙΤΣΗ, *Γεωγραφία της Κοριτσάς και της περιοκίδος*, εν Θεσσαλονίκη 1888, fq. 12.

56 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 40 (27^r), fq. 238.

57 Mbi personalitetin e Joan Bankës, shih Σ. ΜΠΕΤΤΗ, *Ηπειρωτική Ευποιΐα, η βιογραφική συλλογή Ηπειρωτών ευεργετών της Τουρκοκρατίας Α-Β*, bot. Αγαθοεργών Καταστημάτων Ιεράς Μητροπόλεως Ιωαννίνων, Ιωάννινα 1982, 1989, fq. 207-209, ku gjendet edhe bibliografia përkatëse.

58 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 7 (11^r-14^v), fq. 208.

59 *Ibid.*, dok. 141 (75^r), fq. 322.

i shek. XVIII)⁶⁰, ngritja e kullës së përbashkët të sahatit të qytetit (1784)⁶¹ etj.

Veprimtaria ndërtimore gjatë shek. XVIII-XIX⁶² na jep mundësinë për të kuptuar më mirë kushtet e jetesës së banorëve të Korçës. Shtëpitë relativisht të mëdha të arkondëve korçarë, siç rezultojnë nga të dhënat e testamenteve dhe shënimet kronike të kodikut, ishin të rrethuara me mure për arsye mbrojtjeje dhe të ndërtuara njëra krah tjetrës. Veprimtaria ndërtimore e kishës gjatë kësaj periudhe kohore ishte mjaft intensive dhe ecte paralelisht me zhvillimin shoqëror dhe kulturor të vendit. Shembull karakteristik përbën kisha e madhe metropolitane, që përmbante brenda saj tre kisha kushtuar Burimit Jetëdhënës, Shën Harallambit dhe Shën Visarionit, për ndërtimin e së cilët kontribuoi i gjithë komuniteti i Korçës⁶³.

Pra, është më se e qartë se kodiku përbën një burim të rëndësishëm, brenda të cilit pasqyrohen aspekte të larmishme fetare, kulturore, sociale, ekonomike, pedagogjike dhe administrative të jetës në Shqipërinë e Jugut dhe konkretisht në zonën e Korçës. Me këtë rast, bëjmë të ditur se kodiku është përgatitur nga folësi për botim sipas metodologjisë bashkëkohore shkencore të botimit të burimeve historike dhe ndodhet nën proces botimi nga Fakulteti i Historisë i Universitetit të Jonit. Shumë shpejt përmbajtja e plotë e tij do të jetë në dispozicion për të gjithë studiuesit e fushave të interesuara dhe do të kontribuojë në ndriçimin e aspekteve të ndryshme historike të vendit tonë.

60 *Ibid.*, dok. 24 (21r), fq. 232.

61 *Ibid.*, dok. 160/9 (86r), fq. 345

62 A. RËMBECI, "Kodiku i mitropolisë së Korçës dhe Selasforit (shek. XVII-XIX): Të dhëna për kulturën në zonën e Korçës", *Monumentet* 52/2011-2014, fq. 97-125.

63 A. RËMBECI, *The Codex of Korça and Selasphorus*, dok. 160/4 (84r-v), fq. 340.